



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 456

Datë: 14/3/2022

Mbështetur në nenin 17 të Statutit të UP-së dhe shkresën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me nr. prot. 01B/040, datë 9.3.2020 lidhur me zbatimin e UA (MASHTI) Nr. 09/2021, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 10.3.2022, mori këtë:

V E N D I M

për plotësimin-ndryshimin e Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021

1. Pika 4 e Vendimit nr. 4/74, datë 10.12.2021, plotësohet-ndryshohet si në vijim:
 4. Duke filluar nga viti akademik 2021/22, lirohen nga pagesa e regjistrimit të semestrit për herën e parë studentët e kategorisë si në vijim:
 - 4.1. Studentët e rregullt, në nivelin Bachelor;
 - 4.2. Studentët në studimet në nivelin Master;
 - 4.3. Studentët e nivelit Bachelor, një vit akademik pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve;
 - 4.4. Studentët e nivelit Master, një vit akademik pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve;
 - 4.5. Studentët e doktoratës do të lirohen nga pagesat e semestrit të përsëritur, nëse përsëritja e semestrit është shkaktuar nga rrethanat jashtë kontrollit të studentit siç janë: vonesat në caktimin e mentorëve, në realizimin e punës hulumtuese ose në publikimin e rezultateve të punës hulumtuese sipas dëshmive përkatëse të njësive akademike;
 - 4.6. Lirimi nga pagesa sipas nën alineja 4.5 i këtij vendimi, do të bëhet për më së shumti dy semestra gjatë periudhës së studimeve, me vendim të organit kompetent të institucionit i cili mund të merret:
 - 4.6.1. Për individë, grupe ose kategori studentësh të doktoratës për të cilat ekzistojnë njohuri se i plotësojnë kushtet nga alineja 4.5 e këtij vendimi.
 - 4.6.2. Në bazë të kërkesës së argumentuar të studentit ose grupit të studentëve.
 - 4.7. Përjashtimet tjera nga obligimi i pagesës së tarifës së shkollimit dhe shërbimeve administrative të përcaktuara me nenet 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ 09/2021, mund të realizohen vetëm në bazë të legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të veçants të Këshillit drejtues.
2. Në përshtatshmëri me kategoritë tjera, lirimi nga pagesa për kategorinë e studentëve si në alinenë 4.4, nuk nënkupton rimbursimin e pagesave për studentët që i kanë kryer obligimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Studentët e kategorisë si në alinenë 4.4, të cilët kanë kryer pagesën vetëm për njërin semestër të vitit akademik 2021/22, lirohen nga pagesa për semestrin e mbetur për vitin akademik 2021/22.
4. Pikat tjera të Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021, mbesin të pandryshuara.
5. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021.
6. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe do të zbatohet deri në një vendim tjetër.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në mbledhjen e mbajtur më 10.3.2022, ka trajtuar rekomandimet si në shkresën e MASHTI-t, me nr. prot. 01B/040, datë 9.3.2020, lidhur me zbatimin e UA (MASHTI) Nr. 09/2021 aplikimi i pagesave të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë.

Parlamenti Studentor i UP-së, përmes shkresës me nr. prot. 192, datë 2.2.2022, i është drejtuar MASHTI-t me kërkesë për lirimin e studentëve me korrespondencë nga pagesa e tarifës së shkollimit, me rastin e regjistrimit të semestrit për herë të parë, si dhe studentëve të nivelit master, në përshtatshmëri me parag. 2 të nenit 5 të UA (MASHTI) Nr. 09/2021. Parlamenti Studentor i UP-së ndërlidhur me këtë kërkesë, ka pranuar nga MASHTI, shkesën me nr. prot. 01B/040, datë 9.3.2020.


Këshilli Drejtues i UP-së, mbështetur në nenin 116 të Statutit të UP-së dhe Opinionin me nr. prot. 2105, datë 24.11.2021 të MASHTI-t, ka liruar nga tarifat e shkollimit studentët e nivelit Bachelor për një vit akademik pas dëgjimit të ligjëratave të vitit të fundit të studimeve, me vendimin me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021, por jo edhe studentët e nivelit Master.

Meqë neni 116 i Statutit të UP-së është i zbatueshëm për studentët e nivelit Bachelor dhe Master, MASHTI i ka rekomanduar Këshillit Drejtues të UP-së dhe menaxhmentit, që në kuptim të kësaj dispozite t’i lirojë nga pagesa e tarifave të shkollimit për një vit akademik edhe studentët e nivelit Master. Ndërsa, sa i përket lirimit të studentëve me korrespondencë nga pagesa e tarifave të shkollimit me rastin e regjistrimit të semestrit për herë të parë, MASHTI ka konstatuar se këto vende të studimit nuk financohen nga fondet publike dhe si të tilla duhet trajtuar në kuptim të nenit 105 të Statutit të UP-së.

Duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart, me qëllim të zbatimit të plotë të dispozitave të Statutit të UP-së dhe në përputhje me rekomandimin e MASHTI-t, Këshillit Drejtues i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t’u dërgohet:

- Arkivit të UP-së,
- Menaxhmentit të UP-së,
- Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
- Dekanëve të njësive akademike,
- Sekretarëve të njësive akademike,
- Shërbimit të financave në UP.


Këshilli Drejtues i UP-së,
Dr. Sc. Arbëresha Nela - Turjaka